

VENDIM
Nr.8, datë 20.10.2005

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT NË PËRGATITJEN DHE ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR
TË DATËS 3 KORRIK 2005**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor i Kuvendit për hetimin e zbatimit të legjislacionit në përgatitjen dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 3 korrik 2005.

II. Objekti dhe fusha e veprimit të këtij komisioni hetimor duhet të respektojë parimet kushtetuese dhe normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, duke mos cenuar pavarësinë dhe veprimtarinë e organeve të tjera. Këto parime përjashtojnë çdo formë kontrolli parlamentar mbi veprimtarinë juridiksionale të gjykatave.

III. Objekt i hetimit të Komisionit Hetimor Parlamentar është:

a) hetimi i akuzave publike për moszbatimin e legjislacionit zgjedhor në zgjedhjet e datës 3 korrik 2005 nga Komisionet e Qendrave të Votimit, Komisionet e Zonave Zgjedhore dhe Grupet e Numërimit të Votave;

b) Zbatimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve të dala në zbatim të tij, në lidhje me procesin e numërimit të votave për partitë politike dhe koalicionet nga Grupet e Numërimit të Votave, si dhe pasqyrimi i tabelave të rezultateve të grupeve të numërimit në procesverbalin përfundimtar të hartuar nga KZZ-ja;

c) përdorimi i certifikatave të lindjes për votim në datën 3 korrik 2005 në qarkun e Tiranës, në qarkun e Durrësit dhe në qarkun e Beratit, si dhe hetimi i akuzave publike për përdorimin e certifikatave false në këto votime;

ç) hetimi i rrethanave të nxjerrjes së urdhrit të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.166, datë 30.12.2004, me nr.5787 prot. “Për kodet e certifikatave të lindjes lëshuar nga zyrat e gjendjes civile” dhe pasojat e tij në procesin zgjedhor;

d) aktet e nxjerra nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit lidhur me hartimin e listave të zgjedhësve, procedurat e ndjekura për hartimin e listave të zgjedhësve dhe gjendja e tyre; heqja në mënyrë të qëllimshme e zgjedhësve nga listat e tyre dhe dublikimet;

dh) shkelja e dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor në njësitë e qeverisjes vendore në Kolonjë, Berat, Përmet dhe Skrapar, lidhur me kriterin numerik minimal për caktimin e qendrave të votimit;

e) përdorimi i burimeve të administratës publike gjatë fushatës zgjedhore; rasti i dhënies së tokës në komunën Ksamil;

ë) përdorimi i dhunës nga bandat e armatosura në zonën zgjedhore nr.62 Lushnjë, në zonën nr.90 Gjirokastrë dhe në zona të tjera dhe veçanërisht në zonën nr.37 Tiranë, në të cilën u vra zoti Vathi-vëzhgues i Partisë Demokratike në qendrën e votimit;

f) financimet në kundërshtim dhe në tejkalim të dispozitave ligjore nga kandidatët për deputetë.

IV. Komisioni përbëhet nga:

1.Arben Isaraj	Kryetar
2.Bujar Nishani	zëvendëskryetar
3.Paskal Milo	anëtar

- | | |
|----------------------|---|
| 4.Blendi Klosi | “ |
| 5.Rajmonda Stefa | “ |
| 6.Neritan Ceka | “ |
| 7.Ndre Legisi | “ |
| 8.Engjëll Bejtaj | “ |
| 9.Ylli Pango | “ |
| 10.Ferdinand Xhaferi | “ |
| 11.Astrit Patozi | “ |
| 12.Ymer Tola | “ |
| 13.Arjan Madhi | “ |
| 14.Nikollë Lesi | “ |
| 15.Aurel Bylykbashi | “ |

V. Komisioni Hetimor e ushtron vepritimarinë e tij për një periudhë tremujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së Komisionit Hetimor.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)